

TENDERËT NË PANDEMI

ANALIZA E TENDERËVE EMERGJENT NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

QERSHOR 2020



TENDERËT NË PANDEMI

ANALIZA E TENDERËVE EMERGJENT
NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

QERSHOR 2020

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,

10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +383 (0)38 248 038

Email: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Autore: Liridona Behrami

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasades Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Ambasadës Britanike në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	6
Hyrje.....	7
Përmbledhje ekzekutive.....	8
Metodologjia	10
Transparenca Institucionale.....	11
Administrimi i burimeve.....	12
Sigurimi i konkurrencës	13
Raportimi dhe Monitorimi i shpenzimeve gjatë emergjencave	14
Analiza e kontratave për furnizim me produkte dhe material shpenzues medicinal për covid-19.....	15
Konkluzione	30
Rekomandime	32

HYRJJE

Forcat madhore si fatkeqësitë natyrore, luftërat, trazirat, epidemitë etj luajnë një rol të rëndësishëm në funksionimin e zinxhirit të furnizimeve të ndryshme e sidomos furnizimeve medicinale. Në situata të tilla, nuk është e pazakontë që kërkesa për produkte të caktuara të rritet, ndërsa furnizimet të zvogëlohen. Kjo në mënyrë të pae-vitueshme ndikon edhe në rritjen e çmimeve¹.

Pandemia, si forcë madhore që ka goditur tërë botën, duhet të adresohet me masa transparente dhe efektive që kanë prioritet parandalimin e përhapjes së virusit dhe humbjen e jetëve. Në një mjedis të tillë ku presioni dhe pasiguria janë të larta, tregjet pësojnë tronditje dhe ka disproporcion të theksuar midis kërkesës dhe ofertës², gjithnjë ekziston rreziku që vendimarrja publike të kapet ose të shtrembërohet nga interesat e grupeve të caktuara për përfitimin e tyre. Këto rreziqe mund të përfshijnë devijime në financimin e shëndetësisë në xhepa privat të atyre që përfitojnë nga vendimet e prokurimit emergjent, deri në hartimin e pakove të shpëtimit që favorizojnë industrinë dhe kompanitë me lobistët më të aftë, në dëm të sektorëve më pak të lidhur.

Një ndër çështjet më prioritare gjatë kohës së krizave është edhe parandalimi dhe adresimi i rreziqeve të korrupsionit në sistemin shëndetësor. Më shumë se kurrë, duhet të sigurohemi që të ketë transparencë në mënyrë që paraja të investohet dhe shpenzohet aty ku më së shumti ka nevojë. Pra, nëse nuk mund të përmbushet një kontratë, duhet të përcaktohet saktësisht pse ndodh kështu dhe të mblidhen prova të mjaftueshme për ta vërtetuar këtë. Në rast se furnizuesi nuk mund të furnizojë duhet të kërkohej prova specifike.

Përveç sfidave të ndryshme në zingjirin e furnizimit, gjatë krizave globale (siç është rasti i shpërthimit të pandemisë Covid-19) rreziku i korrupsionit në sistemin shëndetësor përkeqësohet nga një presion i shtuar në mënyrë dramatike mbi sistemin, shpesh i shoqëruar me një fluks burimesh shumë të nevojshme. Përçarja, pasiguria dhe shpërqendrimi kontribuojnë në një mjedis, në të cilin aktorët e korruptuar mund të përfitojnë nga kriza. Për këtë arsye, është jetike që transparencja dhe integriteti të ruhen në të gjithë sektorin e shëndetësisë.

Raporti në vijim ka për synim analizimin e disa procedurave të prokurimit **"me negociim pa publikim të njoftimit për kontratë"** të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë gjatë kohës së pandemisë në mënyrë që të vihen në pah sfidat institucionale në përballje me gjendje të pandemisë dhe ndikimin e sfidave globale në zingjirin furnizues.

¹ Oferta dhe kërkesa apo fryrje e çmimeve? Një debat i vazhdueshëm, Harvard Business School, 01 prill 2020

² Sqarim: "1. Kur kërkesa rritet por oferta furnizimi mbetet I njëjtë apo zvogëlohet kjo ndikon në rritjen e çmimit; 2. Kur kërkesa ulet por oferta furnizimi mbetet I njëjtë apo është në rritje, kjo ndikon në uljen e çmimit 3. Ekuilibri I tregut është kur kërkesa dhe oferta janë në harmoni me njëra tjetrën.", *Diagramet e kërkesës dhe ofertës*, Economics Help, shtator 2019.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka filluar të ndërmarë masa për parandalimin e pandemisë Covid-19 që nga janari 2020. Njëra ndër këto masa është edhe blerja e produkteve dhe pajisjeve medicinale të nevojshme për personelin shëndetësor dhe pacientët. Me qëllim të analizimit të procedurave të prokurimit të zhvilluara në përgjigje të situatës pandemike, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), duke përdorur metodologjinë e Transparency International ka analizuar nëntë tenderë për furnizim me pajisje dhe produkte medicinale për mbrojtje nga Covid-19. Në këtë punim janë analizuar veprimet e Ministrisë së Shëndetësisë sa i përket transparencës institucionale, administrimit të burimeve të disponueshme, sigurimit të konkurrencës në aktivitetet e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave në kohë të pandemisë.

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit në përgjigje të nevojave emergjente të shkaktuara nga pandemia Covid-19 (4 mars deri më 28 prill 2020), Ministria e Shëndetësisë ka qenë transparente në publikimin e informatave. Të gjitha dhjetë (10) prokurimet në këtë periudhë ishin zhvilluar **me procedurë të negociuar, pa publikim të njoftimit për kontratë**³ dhe ishin për furnizim me pajisje e produkte medicinale mbrojtëse nga Covid-19, si dhe për shërbime dezinfektimi. Vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara për këto prokurime emergjente ishte 7,128,901.77 euro.

Ministria e Shëndetësisë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik (LPP) kishte njoftuar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë para çdo iniciimi të aktivitetit të prokurimit si dhe kishte sqaruar nevojën e përdorimit të kësaj procedure.

Fillimisht për të realizuar blerjen e produkteve dhe pajisjeve medicinale për mbrojtje nga Covid-19, MSH kishte shfrytëzuar mjetet nga buxheti i saj, ndërsa më pas Qeveria e Kosovës kishte ndarë mjete shtesë për mbrojtje nga Covid-19, në vlerë prej 400 mijë euro si dhe transfer të mjeteve në shumë prej 820,000.00 euro nga nën programi për Aftësim Specialistik. Gjithashtu duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 10 mars 2020⁴ për aprovimin e Planit të veprimit për gatishmëri dhe reagim kundër corona virusit, MSH kishte kërkuar⁵ nga Ministria e Financave dhe Transfereve që të bëjë transferim të mjeteve në vlerë prej 6,230,000.00.

Pasi kishte iniciuar aktivitetin e parë të prokurimit sipas procedurës së negociuar për furnizim me pajisje mbrojtëse medicinale (5 shkurt 2020) dhe pasi kishte pranuar ofertë me çmim shumë të lartë, Ministria e Shëndetësisë anuloi këtë tender dhe menjëherë formoi **komisionin për mbledhjen e çmimeve referente** për pajisje medicinale për mbrojtje nga Covid-19 si dhe verifikimin e stoqeve në depot farmaceutike, në bazë të të cilave pastaj ishin caktuar vlerat e parashikuara në tenderët e publikuar. Edhe pas verifikimit të çmimeve, ofertat e pranuar nga OE në tenderin e datës 4 mars 2020 ishin me çmime më të larta dhe bënë që MSH të kërkonte nga Policia e Kosovës-Departamenti i Hetimeve dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës **hetime lidhur me këtë** çështje.

Për të siguruar konkurrencë sa më të madhe MSH për secilin aktivitet të prokurimit kishte ftuar të ofertojnë 3 deri 21 Operator Ekonomik (OE), ndërsa ishin pranuar 1 deri 5 oferta⁶.

3 Ligji I Prokurimit Publik, neni 35, Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës: Autoriteti kontraktues mund të përdor procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e çfarëdo kontrate publike nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivist të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashikohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

4 Vendimi i Qeverisë më datën 10 mars 2020: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-6-t%C3%AB-t%C3%AB-Quveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>

5 KDI posedon kërkesën me nr. të protokolit 05-1429 të datës 16 mars 2020

6 Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo e negociuar) "Në bazë të aplikacioneve të pranuar, së paku 3 dhe më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse

Ministria e Shëndetësisë përmes gjithsej nëntë tenderëve emergjentë kishte kërkuar furnizim me gjithsej 120 produkte dhe pajisje medicinale, por kishte arritur të lidhë kontrata për vetëm 70 nga këto produkte dhe pajisje medicinale. Po ashtu, një numër i madh i Lot-eve ishin anuluar për shkak të ofertave/çmimeve tejte të larta (27 raste) dhe për mungesë të ofertave (22 raste). Një ofertë ishte eliminuar për shkak se doza e produktit nuk ishte në përputhje me specifikat në dosje të tenderit.

Gjatë analizimit të këtyre kontratave, KDI kishte gjetur se çmimet për disa pajisje medicinale të njehta kanë ndryshuar nga tenderi në tender, siç ishte rasti i çmimit të veshjeve mbrojtëse, i cili në kontratën e 28 prillit 2020 ishte për **74% më i lartë** sesa ai për produktin e njejtë të blerë me kontratën e 4 marsit 2020, ndonëse në përputhje me nevojat, sasisë të kërkuara ishin më të larta deri 4000%. Ndërsa në furnizimet me material laboratorik për testim, disa nga çmimet e produkteve të listuara në kontratën e datës 24 prillit 2020 ishin **47% më të larta** sesa në kontratën e 24 marsit 2020. Sifdoqoftë, analiza tregon se kishte edhe raste kur çmimet e disa materialeve laboratorike ishin **blerë më lirë deri në 42%**. Gjatë fazës së negociimit MSH kishte arritur të sigurojë çmim më të mirë në krahasim me ofertën fillestare vetëm për pesë produkte dhe pajisje medicinale. Për të gjitha produktet tjera, kontratat ishin nënshkruar sipas çmimeve të ofertës, të cilat nuk tejkalonin çmimet e parashikuara.

Në vazhdim komisioni për caktimin e çmimeve referente në tenderin me numër të prokurimit 206-20-1408-1-1-5 të datës 28 prill 2020 kishte caktuar çmimin referent të dorë-

zave kirurgjikale, por gjatë kalkulimit të çmimit referent nuk ka eliminuar çmimet jonormalisht të ulëta (0.04 euro) dhe çmimet jonormalisht të larta⁷ (1.86 euro) të deklaruara nga Operatorët Ekonomik. Çmimet jonormale kanë ndikim negativ në përcaktimin e vlerës së parashikuar, duke e rritur apo ulur atë. Kjo më pas do të ketë implikime edhe në performancën e kontratës dhe kualitetin e produkteve dhe shërbimeve. Në rastin e MSH, sikur këto dy çmime të mos ishin pjesë e kalkulimit të çmimit referent, MSH vetëm në tre lote për blerje të dorëzave kirurgjikale të madhësive S,M dhe L (në kontratën e 28 prillit 2020) do të kursente rreth **97%** të mjeteve.

KDI ka vërejtur se në katër nga nëntë tenderët e MSH-së për furnizim me pajisje medicinale është kërkuar dezinfektues⁸, i cili gjatë pandemisë ishte ndër produktet më të kërkuara në treg. Ky produkt në treg mund të gjindet në disa lloje: me përmbajtje prej 60% alkool (për përdorim të gjerë) dhe 70-95% përmbajtje alkool, për shfrytëzim në klinika⁹. Në thirrjet për tender, MSH nuk kishte definuar përmbajtjen e kërkuar të dizinfektuesit (% e alkoolit). Në kontratën e vetme të lidhurr nga MSH¹⁰, produkti i kontraktuar kishte një përmbajtje alkoholi prej 70% në paketim prej 1 Litër. Ndërsa në tre thirrje të tjera, MSH edhe pse në situatë kur ky produkt ishte shumë i nevojshëm nuk kishte arritur të lidhë kontratë për furnizim për shkak të çmimeve të larta me të cilat kishin ofertuar OE, e që tejkalonin vlerat e parashikuara. Megjithatë, për të zbutur situatën nga mungesa e këtij furnizimi, MSH kishte pranuar donacion rreth 45% të sasisë të kërkuar¹¹.

më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë: Vlera e përgjithshme e tri (3) kontratave, të përfunduara me sukses që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik të përcaktuar në Njoftimin për Kontrate Seksioni III.2.4 pika a) ("operatorët ekonomikë kanë përfunduar me sukses të paktën dy kontrata për furnizim me kompjuterë të një vlere minimale prej 100,000 Euro në secilin vit gjatë dy viteve të fundit");

7 Ligji I Prokurimit Publik neni 61

8 Dizinfektuesi i duarve është një antiseptik për përdorim të gjërë, i cili në treg gjindet si antiseptik me alkool dhe pa alkool

9 "Efikasiteti i kufizuar i xhelve të dorës me bazë alkooli" - Kramer, Axel; Rudolph, Peter; Kampf, Gonter; Pittet, Didier - 27 Prill 2002

10 Kontrata Nr. 206-20-606-1-2-5, i nënshkruar me datën 4 mars 2020

11 Sipas informative të pranuar nga MSH, me datën 28 maj 2020, 10,000 L etanol të pranuar nga Stone Castle, 7,000 L etanol të pranuar nga produktet e konfiskuara nga Dogana e Kosovës. Të dy këto pranime ishin përpunuar dhe paketuar nga TrePharm, dhe 19,000 L donacion nga BE.

METODOLOGJIA

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), degë e Transparency International (TI) në Kosovë, gjatë përpilimit të kësaj analize është shërbyer me metodologjinë e Transparency International¹² për monitorimin e prokurimeve publike gjatë gjendjeve emergjente. Kjo metodologji parasheh vlerësimin/matjen e kërkesave minimale të cilat sigurojnë integritet në kontratat e dhëna gjatë kohës së krizave. Kjo metodologji parasheh matjen e indikatorëve si në vijim:

1. Transparenca dhe hapja e të dhënave:

- o Informacione për mallrat dhe shërbimet e kërkuara përmes prokurimit duke përfshirë specifikacionet teknike të mallrave dhe sasinë e tyre
- o Njësitë dhe çmimet totale të mallrave dhe shërbimeve të blera
- o Llojet e procedurave të përdorura të prokurimit
- o Arsyetimi teknik dhe ekonomik i prokurimit
- o Informacione mbi kërkesat për realizimin e kontratës, si data, vendi, kushtet e dorëzimit
- o Nevoja (arsyeshmëria) ose audienca për të cilën po bëhet prokurimi
- o Autoriteti Kontraktues dhe zyrtarët përgjegjës për prokurimin

2. Administrimi i drejtë i burimeve institucionale

- o Mjetet dhe forma me të cilën sigurohet transparenca e përdorimit të këtyre burimeve.

3. Sigurimi i një konkurrence të drejtë

- o Masat që janë ndërmarrë për të siguruar konkurrencë të lirë e të drejtë, për të shmangur fryrjen e çmimeve dhe për të sanksionuar rritjen e çmimeve

4. Raportimi i shpenzimeve institucionale në kohë

- o Lidhur me shpenzimin e mjeteve që janë ndarë për t'u përballë me pandeminë dhe numrin e kontratave të dhëna

Në këtë hulumtim janë përfshirë nëntë tenderë të shpallur nga Ministria e Shëndetësisë gjatë periudhës 4 mars deri më 28 prill 2020 për të cilat janë konsultuar dhjetra dokumente e vendime të MSH, përgjigjet e MSH të marra përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare¹³ lidhur me tenderët e analizuar, si dhe dhjetra artikuj dhe raporte nga mediat, të cilat trajtojnë situatën aktuale lidhur me prokurimet publike në përgjigje të masave mbrojtëse gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë.

¹² Prokurimi Publik gjatë gjendjes emergjente: kërkesat minimale për sigurimin e integritetit të kontratave të dhëna gjatë krizave, Mars 2020, Transparency International

¹³ Kërkesa për qasje në dokumente publike, data 27 prill 2020, dokumentet e pranuar më datën 30 prill 2020

TRANSPARENCA INSTITUCIONALE

Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit në përgjigje të nevojave emergjente të shkaktuara nga pandemia Covid-19¹⁴ (4 mars deri më 28 prill 2020), Ministria e Shëndetësisë ka qenë mjaft transparente në publikimin e informatave. Të gjitha 10 prokurimet në këtë periudhë ishin zhvilluar **me procedurë të negociuar, pa publikim të njoftimit për kontratë**¹⁵. Nëntë nga këto prokurime ishin për furnizim me pajisje dhe produkte medicinale mbrojtëse nga Covid-19 dhe një ishte për dezinfektimin e hapësirave të brendshme të MSH-së, të Inspektorateve, Qendrës në Nashec, asaj në Vranidoll dhe Akademisë së Policisë në Vushtrri. Vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara për këto 10 prokurime emergjente ishte 7,128,901.77 euro.

Të gjithë tenderët për furnizimin me pajisje medicinale si: maska, dorëza, veshje mbrojtëse, teste, material për testim etj. dhe produkte medicinale apo barna ishin publikuar në platformën zyrtare **E-prokurimi**¹⁶. Dokumentet si Dosjet e Tenderit, vendimet për përzgjedhje të operatorëve të suksesshëm dhe të pasuksesshëm në tender, njoftimet për dhënie dhe nënshkrim të kontratës dhe kontratat ishin të publikuara dhe të qasshme në e-Prokurimi, përderisa dokumentet si kërkesat e njësive kërkuuese, procesverbali i negocimit, ftesat për ofertim, janë kërkuar nga MSH përmes qasjes në dokumente publike më datën 27 prill 2020, dhe janë pranuar më datën 30 prill 2020, rrjedhimisht brenda afateve ligjore. Për të gjitha produktet dhe pajisjet, në tender ishte specifikuar sasia e kërkuar dhe çmimi, ndërsa specifikat teknike ishin përgatitur nga njësiti kërkuuese (Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës dhe Kujdesi Parësor shëndetësor).

Poashtu edhe në kontratat e publikuara ishin të përfshira çmimi për njësi, çmimi total i kontratës dhe të dhënat për Operatorët Ekonomik fitues. Operatorët Ekonomik të cilët ishin fitues të këtyre nëntë tenderëve përfshijnë Made Kos, Liri Med, grupi i operatorëve Neramed & Genius Kosova, Eramed, Komed, Lego, Meditech, Agani dhe Interlab me një çmim total prej 7,093,272.57 eurosh.

Me qëllim të furnizimit sa më të shpejtë, duke marrë parasysh emergjencën e krijuar nga pandemia, MSH ka shfrytëzuar procedurën **prokurimit të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë**. Kjo procedurë e prokurimit është e lejuar me Ligjin e Prokurimit Publik, përkatësisht me nenin 35.2.1 (iii) të këtij ligji. Paraprakisht, MSH kishte njoftuar KRPP-në për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë si dhe kishte sqaruar nevojën e përdorimit të kësaj procedure.

Secila kontratë është e lidhur për një kohëzgjatje të caktuar si dhe ka të përcaktuar afatet kohore për liferim të furnizimeve dhe vendin e dorëzimit të këtyre furnizimeve. Kontratat janë me kohëzgjatje prej një deri në tre muaj ndërsa koha e liferimit të produkteve varion nga 1 deri në 10 ditë, ndërsa vetëm për furnizim me ventilator koha e liferimit ishte deri 70 ditë. Nënshkrimi i kontratave është i rregulluar me nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe konform këtij neni, në MSH kontratat e vlerës së mesme janë nënshkruar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, ndërsa ato të vlerës së madhe janë nënshkruar edhe nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Ministri.

14 04 mars – 28 prill 2020

15 Ligji I Prokurimit Publik, neni 35, Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës: Autoriteti kontraktues mund të përdor procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e çfarëdo kontrate publike nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivi të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashikohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.

16 <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Gjithashtu MSH ka pranuar donacione të shumta të huaja (UNICEF, UNDP, BE, CDF etj.) dhe vendore me pajisje dhe produkte medicinale (kompani të ndryshme). Këto donacione janë të publikuara vetëm në faqet e MSH në rrjetet sociale. Sipas informatave, MSH është në përgatitje të një raporti²⁰ lidhur me të gjitha donacionet gjatë pandemisë.

Komisioni për caktimin e çmimeve referente në tenderin 206-20-1408-1-1-5 kishte caktuar çmim të lartë referent për njësi të dorëzave kirurgjikale, pasi që gjatë kalkulimit nuk kishte eliminuar çmimin jonormalisht të ulët (0.04 euro/njësi) dhe jo-normalisht të lartë (1.86 euro/njësi) të deklaruar nga OE. Nëse komisioni do të kishte eliminuar çmimet jonormalisht të ulëta dhe jonormalisht të larta në kalkulim atëherë çmimi referent për njësi do të ishte 0.24 euro. Rrjedhimisht MSH për tre Lote të dorëzave kirurgjikale do të kishte paguar shumën totale prej 80,709.33 euro e jo **158,981.32 euro** sa pagoi në realitet. Potencialisht vetëm për këto tre lote do të **kurseheshin mbi 60,000 Euro.**

Gjatë kohës së pandemisë, në MSH nuk është evidentuar rritje e numrit të personelit, sido që të jetë janë angazhuar shumë vullnetarë për të ndihmuar për mirëqenien dhe ushqimin e personave të karantinuar në Qendrën e Studentëve, vullnetarë në Qendrën e thirrjeve për Covid-19, si dhe vullnetarë në Linjën e ndihmës psikologjike për Covid-19.

21 Vendimi I pranuar nga MSH në KDI me datën 30.04.2020

SIGURIMI I KONKURRENCËS

Me qëllim të furnizimit sa më të shpejtë, duke marrë parasysh emergjencën e krijuar nga pandemia, MSH ka shfrytëzuar procedurën **prokurimit të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë** dhe për këtë paraprakisht ka njoftuar KRPP-në. Kjo procedurë e prokurimit është e lejuar edhe me Ligjin e Prokurimit Publik, përkatësisht me nenin 35.2.1 (iii) të këtij ligji.

Për të siguruar konkurrencë sa më të madhe në secilin nga 9 tenderët, ndonëse të realizuar përmes procedurave me negociim, pa publikim të njoftimit për kontratë, MSH u kishte dërguar ftesën për ofertim 3 deri 21 Operatorëve Ekonomik. Sidoqoftë jo të gjithë operatorët u janë përgjigjur ftesave me ofertë. Numri i ofertuesve në nëntë tenderët e analizuar ishte nga një deri pesë ofertues.

Pavarësisht që ftesat për ofertim u ishin dërguar një numri të konsiderueshëm të operatorëve, Ministria e Shëndetësisë përmes gjithsej nëntë tenderëve emergjentë kishte arritur të nënshkruajë kontrata për vetëm 70 nga 120 produkte dhe pajisje medicinale të kërkuara. Gjatë fazës së negociimit kishte arritur të sigurojë çmim më të mirë në krahasim me ofertën fillestare vetëm për pesë produkte dhe pajisje medicinale. Për të gjitha produktet tjera, kontratat ishin nënshkruar sipas çmimeve të ofertës, të cilat nuk tejkalonin çmimet e parashikuara. Po ashtu, një numër i madh i Lot-ve janë anuluar për shkak të ofertave/çmimeve tejet të larta dhe në disa raste për mungesë të ofertave.

Duke qenë se kërkesa për pajisje medicinale në kohën e pandemisë është rritur në nivel global kjo ka bërë që edhe çmimet për këto produkte të rriten. Natyrisht që trendi i njejtë është përcjellur edhe në kontekstin e tregut të Kosovës. Gjatë analizës së kontratave për furnizim me veshje mbrojtëse (L,XL,XXL) për Covid-19, është vërejtur lëvizje e konsiderueshme e çmimeve për njësi. Për ilustrim, çmimi për njësi të veshjeve mbrojtëse në kontratën e datës 4 mars 2020 **ishte 7 euro**, ndërsa dy javë më vonë, çmimi në kontratën e **18 marsit ishte 8 euro**. Në kontratën e **28 prillit çmimi për njësi ishte 12.20 euro** që përbën një rritje prej **74% nga çmimi i siguruar përmes kontratës së parë**, ndonëse sasia e kërkuar ishte rritur për 4000%.

Pas pranimi të ofertave në tenderin e datës 4 mars 2020 për furnizim me pajisje mbrojtëse është vërejtur ngritje e çmimeve nga OE (sidomos çmimet e maskave) dhe kjo ka shtyer që MSH të kërkojë nga Policia e Kosovës-Departamenti i Hetimeve dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës(AKK) hetimin e këtyre kontratave²².

22 Kërkesë nga MSH më datën 10 mars 2020 me nr. protokoli 05-1308, si dhe deklarimi i AKK: https://ak.rks-gov.net/lajmi_single/1866/

Për secilën kontratë të nënshkruar, MSH kishte caktuar menaxherët e kontratave të cilët kanë për obligim të sigurojnë që operatori i kontraktuar është duke përmbytur obligimet e kontratës dhe të përpilojnë raporte të menaxhimit të kontratave. Për dy kontrata të përfunduara, raportet e menaxhimit të kontratës janë dërguar tek Sekretari i MSH dhe udhëheqësi i zyrës së prokurimit. Në të njetat, KDI-së i është dhënë qasje përmes kërkesës për qasje në dokumente zyrtare.

23 Bisedë telefonike me MSH më datën 29.04.2020

|||||

ANALIZA E KONTRATAVE PËR FURNIZIM ME PRODUKTE DHE MATERIAL SHPENZUES MEDICINAL PËR COVID-19

Në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik²⁵ dhe sipas Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RrOUPP)²⁶ për rastet e emergjencës ekstreme ekziston mundësia të përdoret procedura e negociuar pa publikuar njoftimin për kontratë, dhe kjo procedurë mund të zhvillohet me një ose më shumë operatorë ekonomik të zgjedhur nga Autoriteti Kontraktues(AK)²⁷.

Nga 4 mars deri me 28 prill 2020, Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar nëntë procedura emergjente për prokurimin e produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Në mënyrë që të sigurojë konkurrencë të mjaftueshme, Ministria e Shëndetësisë për çdo tender emergjent të realizuar nga 4 mars deri me 28 prill 2020 ka ftuar në ofertim 3 deri 21 operator ekonomik.



Në mënyrë që të sigurojë konkurrencë të mjaftueshme, Ministria e Shëndetësisë për çdo tender emergjent të realizuar nga 4 mars deri me 28 prill 2020 ka ftuar në ofertim 3 deri 21 operator ekonomik.

²⁵ Ligji I Prokurimit Publik, Porocedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, 35.2.1(iii)

²⁶ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë neni 52.

²⁷ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik neni 50.2: Për rastet e emergjencës ekstreme ekziston mundësia të përdoret procedura pa publikim të njoftimit për kontratë sipas LPP-së, neni 35.2.1(iii) dhe kjo procedure mund të zhvillohet me një ose më shumë operatorë ekonomik të zgjedhur nga autoriteti kontraktues

|||||

1 TENDERI: “Furnizim Emergjent me pajisje dhe material shpenzues medicinal për mbrojtjen e personelit shëndetësor nga Corona-Virusi” me numër të prokurimit: 206-20-606-1-2-5

Njoftimi për dhënie të tenderit të parë emergjent “Furnizim Emergjent me pajisje dhe material shpenzues medicinal për mbrojtjen e personelit shëndetësor nga Corona-Virusit”²⁸, është publikuar më datën 4 mars 2020, dhe përfshinte tetë produkte (maska, dorëza L-M, veshje mbrojtëse XL-XXL, mburojë për fytyrë, dezinfektues dhe termometer). Për këtë tender janë ftuar tetë OE, ndërsa kanë ofertuar vetëm dy. Fitues i këtij tenderi ishte OE Made Kos, ndërsa OE Agani ishte eliminuar si ofertues i papërgjegjshëm, pasi që kishte ofertuar vetëm me tre produkte ndërsa tenderi kishte tetë produkte dhe nuk ishte i ndarë në Lot-e. Vlera e parashikuar e këtij tenderi ishte 96,324.00 euro, por pas negociimit MSH kishte arritur të nënshkruajë kontratën me vlerë më të ulët prej 94,401.00 euro si rezultat i negociimit/uljes së çmimit për maska nga nga 8.90 në 8.50 euro. Kontrata ishte dhënë për një periudhë një mujore ndërsa mjetet ishin siguruar nga buxheti i MSH të aprovuara nga ndarja buxhetore e vitit praprapk, pasi që nuk ka qenë i aprovuar Ligji për Buxhetin 2020.

LOT	PËRSHKRIMI I PRODUKTIT	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Respiratorë FFP2 (Maska)	4,000	8.50 €	34,000 €
2	Veshje mbrojtëse për tërë trupin, madhësia XL	2,000	7.00 €	14,000 €
3	Veshje mbrojtëse për tërë trupin, madhësia XXL	2,000	7.00 €	14,000 €
4	Mburojë për fytyrë	2,000	5.60 €	11,200 €
5	Dorëza nitrile, pa talk, madhësia M	47,300	0.06 €	2,838 €
6	Dorëza nitrile, pa talk, madhësia L	47,300	0.06 €	2,838 €
7	Dezinfektues për duar së bashku me dispenzer	2,000	6.00 €	12,000 €
8	Termometer infra të kuq për ballë	150	23.50 €	3,525 €
Total:				94,401 €

TABELA 1: Produktet dhe çmimet me të cilat është nënshkruar kontrata me nr. të prokurimit 206-20-606-1-2-5.

²⁸ Njoftimi për dhënie të kontratës data 04.03.2020:

https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=798186

|||||

|||||

2 TENDERI: "Furnizim Emergjent me pajisje dhe material shpenzues medicinal për mbrojtje nga Corona-Virusi" me numër të prokurimit: 206-20-856-1-1-5

Pas ndarjes së buxhetit në vlerë 400 mijë euro nga Qeveria e Kosovës²⁹ (vendimi nr 07/04) për furnizim me pajisje medicinale të nevojshme për parandalimin e COVID-19, MSH me datën 18 mars 2020, ka zhvilluar edhe një procedurë emergjente të prokurimit.

Vlera e parashikuar e tenderit, të ndarë në 10 Lote ishte 399,996.22 euro, ndërsa qëllimi ishte për "Furnizim Emergjent me pajisje dhe material shpenzues medicinal për mbrojtje nga Corona-Virusi"³⁰. Tetë nga 10 Lot-et ishin për pajisje dhe materiale të njehta sikur në tenderin emergjent paraprak 206-20-606-1-2-5, ndërsa dy lote tjera ishin për furnizim me veshje mbrojtëse të madhësisë L dhe qese për kufoma. Për të marrë pjesë në këtë tender ishin ftuar 21 OE, por ftesës i janë përgjigjur vetëm tre OE. Fitues i kontratës për Lot-et 1,2,3,4 dhe 9 ishte grupi i OE Neramed dhe Genius Kosova, ndërsa vlera totale e kontratës ishte 294,245.00 euro. Për dy Lot-et 5 dhe 8 janë dhënë dy kontrata për dy OE, e para në vlerë prej 28,320.00 euro OE Liri Med dhe e dyta në vlerë prej 28,500.00 euro OE Made Kos. Lot-et 6 dhe 7 janë anuluar për shkak se ofertat kishin tejkaluar vlerën e parashikuar në masë substanciale deri më 785% ndërsa për Lot-in 10 nuk janë paraqitur fare ofertues. Gjatë fazës së negocimit oferta fillestare 209,100.00 për maska është zbritur në ofertën përfundimtare 203,745.00 euro.

LOT	PËRSHKRIMI I PRODUKTIT	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Respiratorë FFP2 (Maska)	25,500	7.99 €	203,745 €
2	Veshje mbrojtëse për tërë trupin madhësia L	3,000	8.00 €	24,000 €
3	Veshje mbrojtëse për tërë trupin, madhësia XL	4,000	8.00 €	32,000 €
4	Veshje mbrojtëse për tërë trupin, madhësia XXL	4,000	8.00 €	32,000 €
5	Mburojë për fytyrë	6,000	4.72 €	28,320 €
6	Dezinfektues për duar së bashku me dispenzer	5,209	/	/
7	Termometer infra të kuq për ballë	150	/	/
8	Çarçafa për një përdorim	10,000	2.85 €	28,500.00 €
9	Syza Mbrojtëse	1,000	2.50 €	2,500 €
10	Qese për kufoma	50	/	/
Total				351,065 €

TABELA 2: Produktet dhe çmimet me të cilat janë nënshkruar kontratat Me nr. të prokurimit 206-20-856-1-1-5

29 Vendimi i mbledhjes së Qeverisë së Kosovës me datën 28.02.2020 <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-4-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%AB-s%C3%AB-Kosov%C3%AB-2020.pdf>, nr.07/04

30 Njoftimi për dhënie të kontratës data 18.03.2020 :

https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=806110

|||||

|||||

Tabela në vijim ilustron çmimet e kontraktuara për produktet e njëjta ndërmjet dy kontratave emergjente të sipër cekura:

KONTRATA		206-20-606-1-2-5 (04.03.2020) (a)			206-20-856-1-1-5 (18.03.2020) (b)			Dallimi në Sasi	Dallimi në çmim EURO
Lot	Përshkrimi i produktit	Sasia	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €	Sasia	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €	(b - a)	(b - a)
1	Respiratorë FFP2 (Maska)	4,000.00	8.50 €	34,000.00 €	25,500.00	7.99 €	203,745.00 €	21,500.00	(0.51)
2	Veshje mbrojtëse për tërë trupin, madhësia XL	2,000.00	7.00 €	14,000.00 €	4,000.00	8.00 €	32,000.00 €	2,000.00	1.00
3	Veshje mbrojtëse për tërë trupin, madhësia XXL	2,000.00	7.00 €	14,000.00 €	4,000.00	8.00 €	32,000.00 €	2,000.00	1.00
4	Mburojë për fytyrë	2,000.00	5.60 €	11,200.00 €	6,000.00	4.72 €	28,320.00 €	4,000.00	(0.88)

TABELA 3: Krahësimi ndërmjet dy kontratave të para emergjente me nr. të prokurimit 206-20-606-1-2-5 dhe 206-20-856-1-1-5

Sipas tabelës së më sipërme shohim se me rritjen e sasisë së kërkuar të maskave në kontratën e dytë për 537.5%, çmimi për njësi ishte **5.99% më i lirë**.

Ndërsa tek lotet për furnizim me veshje mbrojtëse për tërë trupin (të dy madhësitë) shohim se edhe pse sasia në kontratën e dytë ishte rritur 100%, çmimi për njësi në krahasim me kontratën paraprake **ishte rritur për 14.28%**.

Tek furnizimi me mburoja për fytyrë, në kontratën e dytë, sasia ishte rritur për 200%, përderisa çmimi për njësi ishte **15.71% më i lirë** se kontrata e parë.

|||||

|||||

3 TENDERI: “Furnizim Emergjent me material laboratorik për testim ne SARS-COV-2 për Corona-Virus” me numër të prokurimit: 206-20-959-1-2-5

Më datën 24 mars MSH ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës për tenderin e tretë emergjent, “Furnizim Emergjent me material laboratorik për testim ne SARS-COV-2 për Corona-Virus”³¹, me vlerë të parashikuar 124,980.00 euro, në të cilin ishin të përfshirë 14 lloje të produkteve (teste, materiale për testim etj.), të cilat kanë të bëjnë me testimin e personave për COVID-19. Për të gjitha këto produkte MSH ka shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik Eramed, me vlerë të përgjithshme të kontratës prej 123,967.00 euro. Për këtë tender ishin ftuar për të ofertuar pesë OE, ndërsa vetëm një OE ka ofertuar dhe njeherit është shpallë fitues. Oferta nga OE ka qënë më ulët se sa vlera e parashikuar nga MSH, ndërsa gjatë negociimit OE nuk ka pranuar të ofroj zbritje për shkak të vështirësive dhe kostos së transportit për shkak të pandemisë.

Nr.	Përshkrimi i produktit ³²	Sasia	Çmimi për njësi me tvsh €	Çmimi total me tvsh €
